



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1177 Prot.

Elbasan, më 28.02. 2024

Vendim

Nr. 280 Datë 28.02/2024

Për përcaktimin e përgjegjësisë dhe kompetencave

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrative të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8,9, 59 e 64 të tij, ligjin 44 datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative”, nenet 28 e 29 të tij, ligjin 10296 datë 8.07.2017 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”,

Vendosa

- 1- Zv/Kryetare e Bashkisë znj. Aulona Bylykbashi, është përgjegjëse për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin, e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Organizative, të Ardhurave, Buxhetit dhe Financës. Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit, dhe strukturave vartëse të tyre
- 2- Në funksion të realizimit të përgjegjësisë si më sipër, Zv/Kryetares znj. Aulona Bylykbashi i delegohen kompetencat si më poshtë:
 - Është “Nëpunës Autorizues” për menaxhimin e buxhetit dhe financave vendore, Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe Koordinator i Riskut.
 - Të kontrollojë dhe nënshkruaj të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
 - Kur për realizimin e funksioneve të përcaktuara në këtë urdhër, është e nevojshme lidhja e kontratave apo marrëveshjeve në të cilat Bashkia është palë, ato mund të nënshkruhen nga zv/kryetari me autorizim të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë,
 - Të verifikojë dhe bëjë shpërndarjen e korespondencës së ardhur në Bashki nga institucionet apo entet e ndryshme, duke ia adresuar strukturave përkatëse.
 - Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si relacione, projekt-vendime etj, që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë të përcaktuara në këtë urdhër, si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të tij
 - Gjithashtu, zv/kryetare znj Aulona Bylykbashi është përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e aktivitetit të Agjencisë së Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit.

- 3- Aktet dhe shkresat zyrtare të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jene njelloj të detyrueshme, per administratën e Bashkise dhe njësitë vartëse të saj.
- 4- Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data 28/02/2024, deri në një urdhër të dytë.
- 5- Zv Kryetare znj. Aulona Bylykbashi nuk mund të delegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera
- 6- Zv/kryetar znj. Aulona Bylykbashi do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim
- 7- Vendimi nr 2475 date 31.10.2023 i Kryetarit të Bashkisë dhe të gjitha aktet e tjera , për delegim kompetencash për zv/kryetaren znj. Aulona Bylykbashi, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
- 8- Ngarkohen zv/kryetare znj. Aulona Bylykbashi dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, me publikimin e tij
- 9- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë

Kryetari
Gledian Llatja

